



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2023:114290

Datë: 05.09.2024

Numri i dokumentit: 06126365

C.nr.609/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, me gjyqtarin Selajdin Gallapeni, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm gjykues, si dhe pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Labinot Demiraj, në çështjen juridike civile të paditësve H.S, S.B, S.B, SH.M, dhe XH.H, të punësuar në Gjimnazin “Jeta e Re” në Suharekë, të cilët i përfaqëson e autorizuar N. H, avokate nga Suhareka, kundër të paditurës Komuna e Suharekës, Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson A. B, përfaqësues ligjor i komunës, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, gjykata jashtë shqyrtimit kryesor, më 05.09.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

- Pa shqyrtim kryesor -

I.APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve H.S, S.B, S.B, SH.M, dhe XH.H, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Suharekës që paditësve në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën 16.08.2021 e deri me datë 21.11.2022, t’ua paguaj shumat siç vijon:

1. Paditësit H. S, për 306 ditë pune, shumën prej 428.40 euro;
2. Paditësit S. B, për 306 ditë pune, shumën prej 428.40 euro;
3. Paditëses S. B, për 244 ditë pune, shumën prej 488.80 euro;
4. Paditësit S. M, për 306 ditë pune, shumën prej 214.20 euro;
5. Paditësit Xh. H, për 306 ditë pune, shumën prej 428.40 euro.

Të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila fillon të rrjedh nga momenti i paraqitjes së padisë 22.05.2023, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.

III.OBLIGOHET pala e paditura që paditësit t’ia kompenson shpenzimet e procedurës kontestimore, në total shumën prej 333.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve të kërkuar përtej shumes së aprovuar, REFUZOHET.

A r s y e t i m

Paditësit, nëpërmjet të autorizuarit, në këtë gjykatë kanë paraqitur padi ndaj të paditurës Komuna e Suharekës, Drejtoria e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit. Ngritja e padisë drejtohet nga fakti se e paditura nuk ia ka kompensuar shpenzimet e udhëtimit paditësve të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës, gjegjësisht nga e drejta objektive, neni 46 paragrafi 2 i Kontratës Kolektive, të lidhur më 18.04.2017, ndërmjet SBASHKU-ut dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenet 5,7 dhe 9 te saj. Paditësit me datën 23.05.2024 ka bërë precizimin e padisë në aspektin objektiv.

E paditura përmes përgjigjes në padi nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë mirëpo ka theksuar se për një pjese të kërkesëpadisë kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesave.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkëngjitur padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore, pas çmuarjes me kujdes dhe me ndërjegje të secilës prej tyre dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

Kërkesëpadija e paditësit është në tërësi e bazuar.

Gjykata nuk u ndal më tutje në vlerësimin e provave, për faktin se e paditura nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë.

Në nenin 35 paragraf 5 të Kontratës Kolektive i datës 22.01.2021 si dhe Kontratës Paraprake 18.04.2017 parashihet që “ *Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*”.

Në lidhje me aprovimin e kërkesëpadisë si në pikën një gjykata vendosi duke u bazuar në 152 të LPK-së “*Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij*”.

Në lidhje me kamatën gjykata vendosi në kuptim të nenit 378 të LMD-së.

Në lidhje me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi që ti bart pala e paditur dhe atë në shumë prej 312€ për përpilimin e padisë, dhe 21 € për taksë gjyqësore në total shumë prej 333.00, me çka gjykata lidhur me shpenzimet vendosi në kuptim të nenit 452 paragraf 1 të LPK-s. Pjesën tjetër në lidhje me precizimin e kërkesëpadisë gjykata e refuzoi për faktin se një precizim i tillë është bërë pa kërkesën e gjykatës.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:114290, 05.09.2024**

G j y q t a r i

Selajdin Gallapeni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.